



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:222975

Datë: 18.08.2024

Numri i dokumentit: 06067762

**PKR.nr.82/23**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**, sipas Kryetares së trupit gjykues Nushe Kuka Mekaj me gjyqtarët profesionist Arben Mustafaj dhe Blerta Kelmendi, anëtarë të trupit gjykues, me bashkëpunëtoresh profesionale Elzana Kastrati, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.S. për shkak të veprës penale *Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 të KPRK-së*, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Rënda nën shenjë PP.I.nr.69/21 të datës 19.09.2023 e përmirësuar me datë 02.07.2024, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me datë 15.07.2024, në prezencë të dëmtuarit L.B. dhe mbrojtësit të akuzuarit av.Bujar Bërdynaj, e në mungesë të Prokurores së Shtetit Valbon Disha Haxhosaj, të dëmtuarve M.D., M.T. dhe M.D., përfaqësuesve të të dëmtuarve av.Osman Cucoviq dhe Sokol Mushkolaj, me datë 18.07.2024, publikisht bie dhe shpall, ndërsa me datë 18 gusht 2024, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari B.S., i biri i .... dhe i nënës ....., e gjinisë ....., i lindur me ..... në ..... ku edhe banon, rruga ....., objekti C 2/4, Lamella D numër 24, ka të kryer Fakultetin Juridik, me profesion noter, tani në pension, i martuar, prind i dy fëmijëve, me numër personal ..... lëshuar nga MPB të R. Kosovës, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës.

**Konform nenit 363 par.1, pika 1.3 të KPPRK-së,**

**LIROHET NGA AKUZA**

Për shkak se:

Me datë 15.10.2020 në Pejë, në zyrën e tij, me dashje direkte e në cilësinë e personit zyrtar – noter, i pandehuri nuk i ka përmbushur detyrat e tij zyrtare të parapara me Ligjin mbi Noterinë (06/L-010) e pikërisht me neni 3 par.1, pika 1.4.2 të këtij Ligji si dhe Ligjin për Trashëgiminë e Kosovës (2004/26) neni 12, 14 dhe 15, e me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete dhe për personat e tjerë, këtu për shitësin M.K., në atë mënyrë që i pandehuri gjatë seancës për shqyrtimin e trashëgimisë, seancë kjo e mbajtur me datë 15.10.2020, pranë zyrës së të pandehurit në fjalë, i njëjti i ka pranuar dokumentet noteriale nga Republika e Serbisë e që kanë të bëjnë me procedurën trashëgimore si deklarata për trashëgimi të trashëgimtarëve D.M., D.M., T.M. dhe D.M., kopjet e letërnjoftimeve, autorizimin për përfaqësim në procedurën trashëgimore të përpiluar dhe të vërtetuar pranë noterës N.S. nga Beogradi R. Serbisë, fare pa i verifikuar saktë përmbajtjen e këtyre dokumenteve duke filluar nga aktvdekja e lëshuar në emër të trashëgimlënësit V.D. (N.), ku tek rubrika afërsia nën a) fëmijët martesor jashtëmartesor dhe të adoptuar, në bazë të aktvdekjes janë konstatuar D.M., D.M., T.M. dhe D.M., e që në bazë të aktvdekjes, rezulton se këta janë trashëgimtar të rendit të parë, kurse i pandehuri gjatë shqyrtimit të procedurës për trashëgimi, në procesverbal ka konstatuar se i njëjti në bazë të dokumentacionit të sjellë nga palët aktvdekjes, certifikatën nga libri i vdekjes, ka vërtetuar se të lartcekurit janë trashëgimtar të rendit të dytë pas vdekjes së V.D. , fare pa e vërtetuar se kush janë trashëgimtarët e rendit të parë dhe lidhjen e trashëgimtarëve të rendit të dytë me trashëgimlënësin V.D. , e që në bazë të provave ka rezultuar se trashëgimtarë të rendit të parë të V.D. , janë dy djemtë M.D. dhe M.D. dhe një vajzë M.D. , duke marrë kështu vendimi ku si trashëgimtar të vetëm sipas certifikatës së pronave P-71611015-01204-1 në Vitomiricë me sipërfaqe 7767 m2, P-71611015-01202-2 në Vitomiricë me sipërfaqe 3159 m2, P-71611015-01203-0 në Vitomiricë me sipërfaqe prej 5354 m2 dhe P-71611015-01204-2 në Vitomiricë në sipërfaqe prej 4053 m2, ka shpallur M.R.D. i lindur me ..... në Beograd, me ç’rast pas shpalljes si trashëgimtar i vetëm M.D., e autorizon M.K.n, për shitjen e palujatshmërisë në fshatin Vitomiricë, me numrat e parcelave të konstatuara si më lartë, duke i shkaktuar kështu dëme të dëmtuarve M.D., M.D., M.D., M.D. T. dhe L.B. në shumë prej 90.000 Euro.

-Me çka kishte për të kryer veprën penale *Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 të KPRK-së.*

Meqenëse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Në kuptim të nenit 453 par.1 të KPPRK-së, shpenzimet procedurale bien në buxhet të Gjykatës.

Të dëmtuarit M.D., M.D. , M.D., M.T. dhe L.B., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

## **A r s y e t i m**

### Historiku i rastit

Me datë 19.09.2023, Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngrit aktakuzë nën shenjën nën shenjën PP.I.nr.69/21, e përmirësuar me datë 02.07.2024, kundër të akuzuarit B.S. për shkak të veprës penale *Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 të KPRK-së*.

Me këtë lëndë, si gjyqtare e çështjes jam ngarkuar me datë 19.09.2023.

Në shqyrtim gjyqësor, pas leximit të aktakuzës, i akuzuari është deklaruar i pafajshëm për veprën penale që i vihet në barrë, andaj gjykata ka kaluar në fazën e administrimit të provave.

Seanca e shqyrtimit gjyqësor me datë 03.04.2024, ka filluar rishtas konform nenit 307 par.1 të KPRK-së, meqenëse ka ndryshuar përbërja e trupit gjykues.

### Fjala hyrëse

Prokurorja e Shtetit Valbona Disha Haxhosaj, në fjalën hyrëse ka theksuar se mbetet pranë fjalës hyrëse të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 09.01.2024, ku mes tjerash tha se pas dëgjimit të dëmtuarit, dëshmitarëve dhe të akuzuarit si dhe pas administrimit të provave materiale, duke përfshirë autorizimet, kontratën, do të vërtetohet përkrahimi faktik dhe juridik i veprës penale për të cilën ngarkohet i pandehuri Bashkim.

Përfaqësuesi i palëve të dëmtuara M.D., M.D. , M.D., M.T. av.Osman Cucoviq, e ka përkrah fjalën hyrëse të prokurores së shtetit, pretendon se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor do të vërtetohet fajësia e të akuzuarit B.S..

I dëmtuari L.B., kanë mbet pranë fjalës hyrëse të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 09.01.2024, duke e përkrah fjalën hyrëse të prokurores së shtetit dhe përfaqësuesit të tij të autorizuar.

Mbrojtësi i të pandehurit B.S., av.Bujar Bërdynaj, ka mbet pranë fjalës hyrëse të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 09.01.2024, në të cilën ka thënë se e kundërshtojnë në tërësi aktakuzën e PTH në Pejë, e cila është ngritur në bazë të një indice lidhur me një autorizim individual dhe i njëjti është përfshirë në një autorizim bartës ku i akuzuari në cilësinë e noterit kishte përpiluar kontratën e shitblerjes sipas dokumentacioneve të dërguara nga Serbia dhe të vërtetuara nga notarija, i cili veprim në atë kohë por edhe sot është veprim i ligjshëm dhe i drejtë sepse në shkresat e lëndës dhe gjatë hetimeve ka munguar autorizimi i cili është në kontratën e shitblerjes me numër YOP3248/20, e i cili është përshkruar në kontratën e shitblerjes, por i mbrojturi i tij ka përfunduar mandatin e tij si noter dhe të gjitha dosjet e lëndës i ka dorëzuar në arkivat e gjykatës, megjithatë ka siguruar një kopje të autorizimit i cili vërteton se e gjithë procedura dhe përpilimi i kontratës së shitblerjes ishte në bazë të dokumentacionit apo autorizimeve të sjella nga M.K., në zyrën e noterit.

I akuzuari B.S. e ka mbështetur deklarinimin e mbrojtësit të tij, duke shtuar se pas administrimit të provave dhe dëgjimit të dëshmitarëve të propozuar në aktakuzë, padyshim se do të vërtetohet pafajësia e tij.

Të dëmtuarit M.D. , M.D. dhe M.T. , dhe M.D., me propozim të prokurores së shtetit në seancën e datë 04.04.2024, e kanë fituar cilësinë e të dëmtuarve.

*Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor të propozuara nga prokuroria*

Janë dëgjuar dëshmitarët:

-L.B., në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 09.01.2024;

-M.K. në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 09.01.2024.

Me propozimin e prokurores së shtetit i mbështetur dhe nga palët në procedurë, në seancën e datës 04.04.2024, janë dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve të dëmtuarit M.D. , M.D., dëshmitari F.K.. Derisa zyrtarisht gjykata ka dëgjuar si dëshmitar nga Oda e Noterëve të Kosovës, Sh.H., në seancën e datës 02.07.2024.

Është konsideruar i tërhequr propozimi i prokurores së shtetit për dëgjimin e dëshmitares M.T.

Janë lexuar provat materiale të propozuara nga prokuroria, si në vijim:

- Kallëzimi penal privat i datës 13.01.2021 parashtruar në P.TH.-D.P. në Pejë nga i dëmtuari Lulëzim ndaj M.K.t së bashku me zgjerimin e kallëzimit penal të datës .22.01.2021 nga i dëmtuari L.B. ndaj B.S.t dhe F.K. nga fq.1 deri në fq.24;
- Raporti Njoftues Policor i D.H.K.E.K. në Pejë i datës 19.10.2021 me numër LP 17/2021(DHKEK/P/182/2021) nga fq.1 deri në nq.217;
- Raporti Njoftues Policor i D.H.K.E.K. në Pejë i datës .21.04.2022 me numër DHKEK/P/182/21) nga fq.1 deri në 47;
- Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.1733/20 i datës 29.07.2022 me të cilin është anuluar absolutisht si e pavlefshme kontrata e shitblerjes;
- Mendimi i Odës së Noterëve me numër Ref.28/ 2023 i datës 10.05.2023.

Me aprovimin e propozimit të përfaqësuesit të autorizuar të palëve të dëmtuarve D. dhe T., av. Osman Cucoviq, është lexuar, prova si vijoni:

- Historiati i lëshuar nga Agjencia për Kadastër në Pejë numër protokollit 01-118/22.

Me aprovimin e propozimit të mbrojtësit të të akuzuarit B.S., av.Bujar Bërdynaj është lexuar, prova si më poshtë:

- Autorizimi YOP-23248/20 lëshuar nga notarja N.S. në Zemun i datës 29.06.2020 në emër të T.M..

Mbrojtja e të akuzuarit është dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës 29.05.2024 dhe me datë 06.06.2024, derisa me 02.07.2024, pasi është dëgjuar dëshmitari Sh.H., i është dhënë mundësia të jap mbrojtjen, i cili ka mbetur në tërësi praj mbrojtjes së dhënë me datë 29.05.2024 dhe datë 06.06.2024.

Fjala përfundimtare

Me datë 15.07.2024, palët kanë paraqitur fjalën përfundimtare.

### Përfundimi i shqyrtimit gjyqësor

Me datë 15.07.2024 gjykata e ka shpallur të përfunduar shqyrtimin gjyqësor në këtë çështje penale.

### Shpallja publike e aktgjykimit

Me datë 18.07.2024, gjykata ka shpall aktgjykimin.

### Deklarimi i dëshmitarëve

Dëshmitari – i dëmtuari L.B., në seancën e shqyrtimit gjyqësor, lidhur me çështjet relevante që janë objekt aktakuze, për pronën e blerë në fshatin Vitomiricë Komuna Pejë, tha se përmes personit me emrin F.K., si fqinjë i tij, pasi ai merrej me shitblerjen e pronave, si ndërmjetësues, ekskluzivisht me pronar serb, në vitin 2020, ishte takuar me të njëjtin, para Komunës së Pejës dhe në bisedë e sipër i kishte treguar se është duke u shitur një pronë të familjes V., nga pasardhësit e tyre, përkatësisht tri vajzat, të cilat i kishte njohur dhe kishte kontakt me të njëjtat, ashtu që i ka rekomanduar që ta kontaktoj M.K.n, të cilin poashtu tha se e ka njohur. Me të rënë në kontakt me M.K.n, ka shkuar për ta shikuar pronën, në bazë të dokumentacionit që e posedonte M.K., si ndërmjetësues dhe i autorizuar për shitje të pronës.

Pas verifikimit të dokumentacionit janë pajtuar që prona të blihet për çmim 90.000 €, ku dhe ishte dhënë kapar prej 500 €, derisa 1500 €, ishin marr vesh t'ia japin pasi të përpilohet kontrata, M.K., në emër të shpenzimeve si ndërmjetësues.

Pas kësaj marrëveshje, kanë shkuar tek noteri B.S., i cili pasi kishte shikuar dokumentacionin, u kishte thënë se të gjitha janë në rregull.

Meqë baxhanaku i tij F., ishte bashkë blerës, e njofton se dokumentacioni sipas noterit ishte në rregull dhe se ishin të njoftuar se vendimi i trashëgimisë ishte shpallur në gazetën zyrtare, së bashku me bashkëshorten, dhëndrin dhe vjehrrën, si blerës të përbashkët, kanë shkuar tek noteri

në fjalë dhe është përpiluar kontrata, ku si shitës me autorizim ka qenë M.K., ishte bërë pagesa e më pas prona kishte dal në regjistra kadastral në emër të tyre.

Pas 4 javësh, tha se e kishte kuptuar se ishte i mashtruar nga M.K. dhe F.K., pasi kishte pranuar me postë një dokumentacion, përkatësisht se ishte ushtruar padi nga i autorizuari i familjes D., avokati Osman Cucoviq, me arsyetim se prona ishte shit mbi bazën e dokumentacionit të falsifikuar, rrethanë të cilën ia kishte konfirmuar dhe noteri B.S., që sipas tij edhe ai e kishte kuptuar të njëjtën kohë, derisa F. dhe M., në prezencë të noterit tha se i kanë premtuar se do ta gjejnë M. D., si trashëgimtar i vetëm i pasurisë së shitur, me autorizim bartës tek M.K., për të kuptuar se çka kishte ndodhur.

Nga deklarata e dëshmitarit M.K., rezulton se ai ishte i autorizuar i familjes D., për të kryer procedurën trashëgimore e më pas dhe të shes pronën e familjes D.. M. D. shtoj se me profesion ishte taksist dhe udhëtonte edhe në Serbi, njëkohësisht ishte marr edhe me shitblerje të pronave, andaj si ndërmjetësues, kishte takuar M. D., në vitin 2020, e më pas ka pas dhe kontakte telefonike, e i cili i kishte treguar se ka një pronë në Kosovë dhe ka interes ta shes. Prona tha se kishte qenë në emër të tri grave dhe një burri, i cili kishte vdekur, andaj dhe duhej fillimisht të kryhej procedura e trashëgimisë, ashtu që i kishte dërguar gjithë dokumentacionin e duhur, pasi për këtë e kishte kontaktuar noterin B.S., lidhur me dokumentet që duhej kompletuar.

Me të siguruar dokumentacionin e nevojshëm, i noterizuar në Serbi nga notarja, N.S. , si i autorizuar i trashëgimtarëve, nga i akuzuari, është kryer procedura e trashëgimisë.

Pas kryerjes së trashëgimisë, është autorizuar të shes pronën nga trashëgimtarët në fjalë, pos M. , trashëgimtare në ½ e pjesës tjetër të pronës, kanë qenë M.D., M.T. , dhe D.M., të cilat e kishin autorizuar M. D., se ka të drejtë të shes dhe të bartë autorizimin tek personi i tretë, andaj dhe kontrata e shitblerjes është përpiluar mes tij si shitës me autorizim bartës dhe blerësve në tjetrën anë.

I gjithë dokumentacioni tha se ishte siguruar nga M. D., me të cilin ishte takuar në kufi me Shqipërinë dhe në kufi me Mal të Zi, e i cili dokumentacion ishte dërguar tek noteri B.S..

Meqë ishte pandemi, dokumentacioni kishte mbetur tek noteri për 2 muaj, më pas ishte ftuar të nënshkruhet kontrata nga palët, transferimi i parave ishte bërë në emër të tij, të cilat i ka tërheq

dhe ia kishte dorëzuar M. , në kesh dhe atë dy herë radhazi, me të cilin ishte takuar në Shqipëri dhe Mal të Zi. Si ndërmjetësues dhe i autorizuar i tyre, pas marrjes së parave në emër të shitblerjes, tha se M., ia kishte dhënë 3.000 € ndërsa L. 1.000 €.

Pasi kishte përfunduar e gjithë procedura, e kishte thirr noteri që të shkonte tek ai në zyre, pasi i njëjti ishte njoftuar nga av. Osman Cucoviq, se diçka nuk ishte në rregull me dokumentacionin e sjell, poashtu në zyre të tij kishin shkuar tri pronaret e tokës, të cilat noterit i kishin treguar se ato nuk kanë shitur tokë dhe nuk i kanë dhënë askujt autorizim dhe se personin me emrin M. nuk e njohin.

Me të marrë këtë informacion, ka provuar ta kontaktoj M., por nuk ka arritur, derisa të dëmtuarit Lulzim, i ka premtuar se nuk do e humb tokën, pasi edhe vet kishte qenë i mashtruar dhe do të ia kompensonte në çfarëdo mënyre qoftë edhe përkundër se ai ishte i bindur se dokumentacioni ka qenë në rregull pasi ishte i noterizuar tek noterja N.S..

Nga deklarata e dëshmitarit F.K., vërtetohet se të dëmtuarin L.B. e ka fqinjë dhe se në vitin 2020, ishte pyetur nga i njëjti, nëse ka tokë në Vitomiricë, në shitje, e meqë merrej me shitblerje, i propozon të kontaktoj M.K.n, ngase ai kishte më shumë informacione rreth një paluajtshmërie që shitej në Vitomiricë.

Më pas, tha se janë të takuar në një çajtoje te Shkolla Ekonomike me M.K.n një shok i tij, dhe L.. Qëllimi i takimit ishte vetëm t'i vë në kontakt, andaj dhe e ka sugjeruar L. që fillimisht të shkojë tek noteri për t'i verifikuar dokumentet dhe më nuk ka pas asnjë kontakt me të njëjtit, mirëpo pas një muaji, pra pasi kishte përfunduar shitblerja dhe ishte bërë pagesa dhe pasi L. ia kishte dhënë 2000 €, si ndërmjetësues që ka qenë mes shitësit dhe blerësit, L. kishte shkuar tek shtëpia e tij dhe i kishte treguar se dokumentet nuk kishin qenë në rregull.

Nga deklarata e dëshmitares/dëmtuarës M.D., vërtetohet se bashkëshorti i saj V. D., ka vdekur në vitin 1996 në Vitomiricë dhe se deri në atë kohë kishin jetuar në banesën e tyre në Pejë banesë, por tokën e kanë pas në Vitomiricë, në sipërfaqe prej 2 hektar dhe 23 ari, në pronësi të bashkëshortit dhe kunatit D. V., i cili ka ndërruar jetë në vitin 2012.

Bashkëshorti tha se i kishte lënë dy vajza M.D. dhe M.T. , derisa kunati i ka lënë dy djem dhe një vajzë D. M., D. M. dhe D. M.. Pas vdekjes së bashkëshortit, ishte kryer trashëgimia dhe



pjesa e tij ishte bartur në emër të saj dhe dy vajzave të bashkëshortit, derisa pjesa e kunatit ka mbetur në emër të tij edhe pas vdekjes, derisa personin me emrin D. M., tha se nuk e kanë në farefisni, por pasi kishin kuptuar se pasuria e tyre ishte shitur, kanë verifikuar dhe kanë vërtetuar se ekziston një M. D., i cili ishte i paralizuar, por asnjëherë nuk e kanë parë e as takuar.

Me tej shtoj se, pasi bashkëshorti ishte i varrosur në Vitomiricë, varrezën e tij kanë ardhur për ta vizituar çdo vit, andaj dhe me të ardhur në Kosovë, e kishin kuptuar se prona e tyre ishte shitur, ashtu që vajzat më pas janë marrë me atë çështje.

E pyetur lidhur me aktvdekjen e lëshuar në Krushevc me datë 07.09.2020, se koha e vdekjes për V. D. N., rezulton të jetë 21.02.2012 dhe si trashëgimtar ka rezultuar të jenë D.M., D.M., T.M. dhe D. M., që ka të bëjë pronën në Vitomiricë, prej 1 hektar 76 ari, ajo tha se personi në aktvdekje ishte kunati i saj, data e vdekjes së kunatit ishte e saktë, për personat e shënuar në aktvdekje, tha se ishte emri i saj dhe i dy vajzave, derisa M. D. nuk e njihnte dhe nuk e kanë në farefisni.

Notaren N.S., tha se nuk e njeh dhe se në dokumentacion e prezantuar nga gjykata, si për trashëgimi, ashtu dhe për shitblerje, nuk ishte nënshkrimi i saj.

Nga deklaratatë të dëshmitares/dëmtuarës M.D., vërtetohet se është e bija e tani të ndjerit V. dhe nënës D. dhe kanë jetuar në banesën e tyre në Pejë në rr. Ganimete Terbeshi, nr.3, ndërsa tokën e kanë pas në Vitomiricë në sipërfaqe prej 1 hektar e gjysmë dhe një hektar e gjysmë ka qenë e axhës. Pas vdekjes së babit në vitin 1996, në vitin 2005, kanë zhvilluar procedurën e trashëgimisë në Çaçak, pasi atje kanë qenë me banim, ashtu që si trashëgimtarë të rendit të parë, për pasurinë e lënë nga babai, janë shpall bashkëshortja e tij M., motra e dëshmitares M.T. dhe vet dëshmitarja pra M. D. me  $\frac{1}{3}$  e  $\frac{1}{2}$  së pronës, derisa  $\frac{1}{2}$  tjetër e pronës ka mbet në emër të xhaxhait.

Personin me emrin M., e as babain e tij, tha se nuk e njohin dhe nuk i kanë në farefisni, derisa të pandehurin B.S., tha se ka pas rastin ta njoh, pasi kishte kuptuar se prona e tyre ishte shitur, përkatësisht kur kanë arritur në Kosovë, kanë shkuar në shërbim kadastral, dhe aty u është thënë se prona evidentohet në emër të L.B. dhe dy personave tjerë, pra ishte shit edhe prona e axhës. Menjëherë pas kësaj kanë shkuar në zyre të noterit, i cili u ka prezantuar dokumentacionin dhe pas shikimit kanë vërejtur se kopjet e lejeve të njoftimit nuk janë të tyre, ashtu që kanë paraqitur kallëzim penal në Serbi, poashtu kanë shkuar edhe tek noterja N. në Zemun, e cila ishte befasuar,

se si ishte e mundur të përdorej emri dhe vula e saj si notere, ku më pas më pas nga policia ishte vërtetuar se të gjitha dokumentet e noterizuara në emër të saj kanë rezultuar të falsifikuara andaj dhe përmes ILCEU, informacioni ishte përcjell tek Institucionet e Kosovës.

Sa i përket aktvdekjes, ajo tha se tani më nuk lëshohet aktvdekje, lëshohet vetëm certifikata e vdekjes dhe lëshohet në zyrën e ofiqarisë dhe trashëgimtarët aty shënohen automatikisht, por nuk ishte në dijeni se kur kishte filluar kjo procedurë, zyrtari atje këtë ia kishte thënë, pra se ka 7 apo 8 vite që nuk lëshojnë aktvdekje të tilla.

Nga deklarata e dëshmitarit Sh.H., i cili mes tjerash tha se me profesion është noter dhe kryetar i Odës së Noterëve dhe sa i përket dokumentacionit që është i noterizuar në ndonjë shtet tjetër përfshirë dhe shtetin e Serbisë, qoftë autorizim apo dokument tjetër, tha se pranohet vetëm nëse e ka formën e duhur, derisa për t'u përpiluar një kontratë për shitblerje mjafton që noteri të ketë autorizimin bartës, nuk është e nevojshme t'i ketë edhe autorizimet burimore, por sipas tij, është e mirëseardhur që të jenë në shkresat e lëndës, atë tha se zakonisht mbesin tek noteri që e ka bërë autorizomini bartës.

Me tej tha se, në çdo rast klientët informohen se autorizimet e prezantuara, në shikim janë përpiluar dhe vërtetuar në mënyrë të rregullt ligjore dhe si të tilla i pranon çdo noter, pra si të ligjshme dhe të vërteta edhe pse në secilin akt noterial, ju tërhiqet vërejtja palëve për këtë çështje.

Sa i përket dokumentacionit për përpilim të kontratës së shitblerje, noteri fillimisht kërkon certifikatën e pronësisë, për të verifikuar kush është pronar i asaj prone, pronari identifikohet me dokument identifikues, letërnjoftim apo pasaportë nëse është prezent, nëse përfaqësohet nga avokati apo ndonjë person tjetër kërkohet autorizimi i personit që përfaqëson, dokumenti identifikues merret vetëm në shikim, në këtë rast autorizimi duhet të jetë i vërtetuar nga organi kompetentë, si noteri, gjykata apo ndonjë shërbim tjetër varësisht nga shteti që aplikon. Noteri mund të verifikoj nënshkrimin e autorizim dhënësit vetëm në shikim dhe bëhet verifikimi i nënshkrimit në letërnjoftim apo pasaportë.

Sa i përket procedurës së trashëgimisë, si dëshmi duhet të jetë aktvdekja si dokument kryesor, i cili normal duhet të jetë i lëshuar nga ofiqari, si bazë për inicimin e procedurës trashëgimore për të ndjerin. Dokumentet që pranohen duhet të kenë përmbajtje të saktë për trashëgimtarët e shënuar në aktvdekje dhe pasurinë që e ka bartë mbi vete, sepse gjatë shqyrtimit të trashëgimisë

tha se bëhen disa deklaratat shtesë bashkë me këtë çështje, se a janë gjithë trashëgimtarët e shënuar apo ka edhe tjerë, këtë deklaratë e japin të pranishmit do të thotë trashëgimtarët e nëse janë me autorizim, do të shënohet në atë autorizim i cili mund të jetë bashkë me deklaratë që duhet të ceket se janë trashëgimtar legjitim të trashëgimlënësit.

Si noter, tha se reciprociteti faktik nënkupton pranimin e dokumenteve të Kosovës, pra noteriale nga shtetit tjetër, që më pas edhe nga noterët në Kosovës pranohet dokumenti i shtetit tjetër, e që janë me mijëra autorizime që janë përcjell në shtetin e Serbisë dhe të gjitha janë pranuar, qoftë për qytetar qoftë për pensionist.

I pyetur se në Serbi a lëshohet nga ana e ofiqarit aktvdekja, tha se nuk e di sigurt, por mendon që është i njëjti sistem pasi nuk ka pas qasje, megjithatë mendon nëse lëshohet nga ofiqaria e merr vule apostile në gjykatë, ai mund të jetë i pranueshëm.

Në aktvdekje, tha se nuk është obligative të shënohet emri dhe mbiemri i trashëgimtarit dhe lidhja e gjakut, një gjë e tillë nuk shënohet as në aktvdekje që lëshohen në Kosovë edhe pse ishte dashur të shënohen, e në rastet kur nuk shënohet, verifikohet në bazë të dokumenteve tjera, por në vendim të trashëgimisë, duhet të potencohet nëse është trashëgimtar i rendit të parë apo të dytë, kjo mjafton, për shkak se e gjithë procedura trashëgimore bazohet në autorizime dhe deklaratat trashëgimore që i sjell i autorizuari.

Pas shikimit të dokumentacionit të procedurës së trashëgimisë që është objekt aktakuze, tha se personalisht nuk ka pas ndonjë rast të zhvillimit të procedurë trashëgimore bazuar në dëshmi-aktvdekje lëshuar nga Republikës së Serbisë, mirëpo sa i përket dokumentacionit të dhënë në shikim, për zhvillimin e procedurës së trashëgimisë, konstatoj se dokumentacioni në fjalë është në rregull, duke përsëritur dhe njëherë se dokumentet i verifikojnë në shikim dhe përmbajtje dhe se a janë të vërtetuara ligjërisht, të kompletuara në përmbajtje dhe se në rastin konkret, autorizimet që i janë dhënë në shikim si shkresa të lëndës, e që kanë të bëjnë me deklaratë mbi trashëgimin, nuk është e thënë që të shënohet se në dobi të kujt heqin dorë, është e mjaftueshme që të thotë se nuk e pranon pjesën trashëgimore, pasi ekzistojnë tri deklaratat trashëgimore, e pranoj pjesën trashëgimore, nuk e pranoj, e pranoj dhe ja cedoj personit të caktuar.

Pasi i epet në shikim autorizimi bartës numër 7034/2020, që ka të bëjë me shitjen e patundshmërive, dëshmitari deklaroi se ky është autorizimi mbi bazën e të cilit është përpiluar

kontrata, është i mjaftueshëm dhe se do të ishte e mirëseardhur të jenë në formë fizike autorizimet burimore, por nuk është obligative me qenë.

Referuar aktvdekjes për të ndjerin V. D., ku në kolonën afërsia nën “a” tek fëmijët martesor, jashtë martesor dhe të adoptuar janë konstatuar emrat e trashëgimtarëve D.M., D.M., M. T. dhe D.M., tha se sipas shënimit në aktvdekje, të njëjtit janë trashëgimtar të rendit të parë.

Mirëpo nëse kanë qenë katër trashëgimtar, sqaroj më tej, se nëse tre heqin dorë nga pjesa trashëgimore dhe mbetet vetëm një, vlerëson se është në rregull, nëse në deklarata trashëgimore kanë deklaruar se heqin dorë nga pjesa trashëgimore.

### Provat materiale

Nga kallëzimi penal privat i datës 13.01.2021 parashtruar në P.TH.-D.P në Pejë, vërtetohet se nga i dëmtuari L.B., është ushtruar kallëzim penal ndaj M.K.t për veprë penale mashtrim nga neni 335 të KPRK-së, dhe zgjerim i kallëzimit penal i datës 22.01.2021 ndaj B.S.t dhe F.K. për veprë penale secili veç e veç të mashtrimit nga neni 335 të KPRK-së.

Nga raporti Njoftues Policor i D.H.K.E.K në Pejë i datës 19.10.2021 me numër LP 17/2021 (DHKEK/P/182/2021), janë vërtetuar veprimet e ndërmarra të zyrtarëve policor për sigurimin e dokumentacionit që kishin të bëjnë me procedurën trashëgimore të zhvilluar nga i akuzuari S., në të cilin raport është konstatuar se janë dëgjuar të gjithë dëshmitarët dhe në bazë të dëshmive të tyre, referuar dokumenteve të gjetura në dosjen e trashëgimisë përkatësisht autorizimeve, kopjeve të letërnjoftimit, aktvdekjet, në bashkëpunim me ILECU, nga të cilët me datë 08.10.2020 sipas përgjigjes me numër ref I-1466-21-29 të organeve të R. Serbisë, është verifikuar i gjithë dokumentacioni që është përdorur në procedurën e trashëgimisë nga i akuzuari B.S. dhe nga ai njoftim është vërtetuar se i gjithë dokumentacioni i përdorur për zhvillimin e procedurës së trashëgimisë e i vërtetuar tek noterja N.S., përkatësisht autorizimet UOP-SH:874-2020 të datës 07.11.2020, UOP-II:1050-20, UOP-I:1051-20 dhe UOP-I:15052-20 janë të falsifikuara këtë e ka pohuar edhe vetë noterja me përgjigjen e saj të datës 06.07.2020. Po ashtu është vërtetuar se edhe aktvdekja e përdorur me rastin e procedurës trashëgimore të datës 09.07.2020, nuk ka qenë e lëshuar nga ofiqaria Krushevc, kjo e vërtetuar me njoftimin e këtij institucioni të datës 05.04.2021. Këtij raporti i janë bashkangjitur edhe autorizimet në bazë të të cilave është përpiluar kontrata e shitblerjes tek i akuzuari B.S. e datës 01.12.2020, si dhe autorizimi bartës UOP-II-

7034-2020 i përpiluar me datë 10.11.2020 në Zemun-Beograd, noterizuar nga noterja N.S., ku D. (R.) M. në bazë të katër autorizimeve burimore të dhëna nga D.M., D.M., T.M., të cilat sipas autorizimeve burimore kishin autorizuar D.M. që të shes pasurinë e tyre, përkatësisht të parcelave të sipërshtënuara ku ishin trashëgimtare në 1/6 e pronës dhe po në të njëjtat autorizime është autorizime është autorizuar D.M., që autorizimin e dhënë ta bartë tek M.K., mbi bazën e të cilit dhe është përpiluar kontrata e shitblerjes.

Nga raporti njoftues policor i D.H.K.E.K. në Pejë dt.21.04.2022 me numër DHKEK/P/182/21), janë vërtetuar të gjitha veprimet e ndërmarra nga hetuesit e Njësisë Rajonale për hetime të krimeve, në të cilin raport është bashkangjitur i gjithë dokumentacioni që ka të bëjë me procedurë të trashëgimisë të zhvilluar tek noteri B.S., i cili dokumentacion përpos dokumentacionit të bashkangjitur në raportin e cituar më lartë, ka përfshirë dhe dokumentet si procesverbalin e mbajtjes së seancës për procedurë trashëgimore të datës 15.10.2020 pranë noterit-këtu të akuzuarit B.S., ku prezent kanë qenë M.K., si i autorizuar i trashëgimtarëve me autorizime për secilin trashëgimtar veç e veç të noterizuara të noterja N.S., se bashku me deklaratat trashëgimore, kopjet e letërnjoftimeve të trashëgimtarëve, personit të autorizuar si dhe vërtetimin për identitetin e trashëgimtarëve të noterizuara tek noterja N.S., aktvdekja, fletat poseduese të pronës, vendimi për trashëgimin me numër rendor 2711/2020 me ref.1052/2020 të datës 15.10.2020, provat lidhur me pranim dorëzimin e mjeteve për shitblerjen e pasurisë, si dhe njoftimin për trashëgimtarët të datës 15.09.2020 me numër 179/2020 i shpallur në gazetën zyrtare të R. Kosovës me datë 15.09.2020.

Nga Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.1733/20 dt.29.07.2022, vërtetohet se është anuluar si absolutisht e pavlefshme kontrata e shitblerjes me numër rendor 3230/2020 dhe numër Ref.1265/2020 dt.01.12.2020 datës 01.12.2020, për shkak se të gjitha autorizimet në shkresat e lëndës e të cilat janë përdorur para noterit në Pejë, B.S., janë dokumente të falsifikuara nga ana e N.N. personave.

Sa i përket mendimit të Odës së Noterëve me nr. Ref.28/ 2023 dt.10.05.2023, gjykata të njëjtit nuk i është referuar pas parasysh se nuk ka të bëjë fare me përshkrimin faktik të ndryshuar në fjalë përfundimtare nga prokuroria, dhe se ky mendim ndërlidhet me përshkrimin faktik për të cilin fillimisht është ngarkuar i akuzuari S..

Nga Historiati i lëshuar nga Agjencia për Kadastër në Pejë nr. prot 01-118/22, rezulton se në vitin 1956 ngastra kadastrale me numër 1202-2, 1203-0, 1204-1 dhe 1204-2 ZK në Vitomiricë, kanë qenë në pronësi të V. (N.) D. dhe V. (N.) D. me nga ½, sipas fletës poseduese Nr.170. Në vitin 2005 (regjistri i ndryshimeve nr.104/2005), ½ e ngastrave kadastrale si më lartë nga V. (N.) D., kalojnë në pronësi të M.D., M.D. dhe M.T. , me nga 1/6 e ½, në bazë të Aktvendimit mbi trashëgiminë të datës 22.11.2005.

Në vitin 2020 (regjistri i ndryshimeve 330/2020) ½ e ngastrave kadastrale si më lartë, nga V. N. D., kalojnë në pronësi të M.R.D. me ½ e ½ pronësisë në bazë të Aktvendimit mbi Trashëgiminë me numër rendor 2711/2020 ref. 1052/20 të datës 15.10.2020 (që është objekt akuze i përpiluar nga noteri B.S.).

Në vitin 2020 (regjistri i ndryshimeve nr.374/2020) ngastrat kadastrale të cekura më lartë nga M. D. me ½ të M.D., M.D. dhe M.T. me nga 1/6 kalojnë në pronësi të L.B., F.H. dhe S.I. me nga 1/3 në bazë të kontratës së shitblerjes me numër rendor 3230/2020 ref.1265/2020 të datës 01.12.2020 përpiluar nga këtu i akuzuari B.S., e që është objekt akuze.

Nga Autorizimi YOP-23248/20, lëshuar nga noterja N.S. në Zemun i datës 29.06.2020 ne emër të T.M., vërtetohet se ka qenë në posedim të M.K.t, si autorizim burimor.

Sipas njoftimit nga ILECU i Republikës së Serbisë të datës 08.10.2021 me numër të ref. I-1466-21-29 lidhur me verifikimin e validitetin të dokumentacionit të përdorur nga i akuzuari B.S. dhe dëshmitari M.K., është vërtetuar se i gjithë dokumentacioni i cili është përdorur me rastin e vendimit mbi trashëgimin me numër rendor 2711/20 dhe Ref.nr.1052/20 të datës 15.10.2020 të përpiluar në zyrën noteriale të akuzuarit Bashkim si dhe kontratën për shitblerje nën numër rendor 3230/2020, Ref.1265/2020 dt.01.12.2020, ka rezultuar i falsifikuar.

Nga kontrata mbi shitjen e palujtshmërisë me numër rendor 3230/2020 dhe numër të Ref.1265/2020 dt.01.12.2020, e vulosur dhe nënshkruar nga të gjitha palët, vërtetohet se parcelat kanë kaluar në pronësi të L.B., F.H. dhe S.I. .

Nga shkresa e dt.11.03.2021 Noterja N.S. është vërtetuar se dokumentet UOP-S-8742-2020 të datës 07.12.2020, UOP-I-1050-20, UOP-I-1051-20 dhe UOP-I-1052-20, të gjitha të datës 06.07.2020 nuk janë përpiluar e as noterizuar në zyrën e saj.

Sa i përket provave materiale, kjo gjykatë i mori të besueshme të siguruara në mënyrë të ligjshme dhe si të tilla i pranoi, nga të cilat u vërtetuan deponimet e të gjithë dëshmitarëve si më lartë, pra se kanë rezultuar të falsifikuara, u vërtetua nga njoftimi i ILECU, e mbi bazën e të cilave u nxor vendimi i trashëgimisë dhe u përpilua kontrata e shitblerjes nga i akuzuari, për të cilat e kishte kuptuar më vonë se janë të falsifikuara, përkatësisht dokumentet në të cilat u bazua aktvendimi i trashëgimisë dhe ato për përpilim të kontratës, të noterizuara tek noterja N.S. .

### Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari B.S., mes tjerash ka thënë se në vitin 2020, ka punuar si noter në Komunën e Pejës. Detyrat dhe përgjegjësit e tij kanë qenë të përcaktuara me Ligjin për Noteri dhe akte nënligjore që parashohin përpilimin e akteve noteriale dhe vërtetimin e dokumenteve të ndryshme.

Familjen D., tha se e ka njohur mbi bazën e dokumentacionit që i ishte sjellë në zyrën e tij nga M.K., si person i autorizuar nga familja D., për zhvillimin e procedurës trashëgimore, e më pas edhe përpilimin e kontratës për shitblerjen e patundshmërisë, pra certifikatën e vdekjes për trashëgimlënësin V. D. N., aktin e vdekjes të vërtetuar nga Ofiqaria në Kryshevc dhe të vërtetuar nga Gjykata Themelore në Kryshevc, me emrat e trashëgimtarëve ligjor të trashëgimlënësit dhe autorizimet e kompletuara me të gjitha shënimet personale të nënshkruara nga palët, ndërsa letërnjoftimet e tyre kanë qenë të vërtetuara me klauzolën mbi vërtetimin e identitetit nga noterja N.S. dhe të gjitha e kanë pas formën e duhur ligjore dhe se janë punuar nga një noter profesional, që nuk ka lënë hapësirë për asnjë dyshim se ato mund të jenë të falsifikuara.

Me tej tha se të tre bashkëpronarët e patundshmërisë me autorizimet e përpiluara me datë 29.06.2020, nga noterja N.S. , e kanë autorizuar M. D. që në emër të tyre t'i ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për lidhjen e kontratës së shitblerjes. Në bazë të autorizimeve të cekura M. D. me datë 20.11.2020, në emër të tij personal dhe në emër të bashkëpronarëve të tij e ka bartë të drejtën e shitblerjes së palujatshmerisë në M.K.n, i cili e ka nënshkruar kontratën në emër të personave të lartcekur, mbi bazën e autorizimit bartës i cili i përmban të gjitha të dhënat e dhënësit të autorizimit, të gjitha të dhënat e tre bashkëpronarëve të patundshmërisë, siç dhe ka përmbajt numrat dhe datat me të cilat autorizime, bashkëpronarët e kanë autorizuar M. D., që në emër të tyre të kryej transaksionin e shitjes e më pas ta bartë pronësinë në blerësit, andaj si noter ka vlerësuar se ka qenë i mjaftueshëm ky autorizim bartës dhe nuk kanë qenë e detyrueshme të

jenë autorizimet individuale të shitësve, në shkresa të lëndës, por ishte e mirëseardhur që edhe ato të jenë.

Sa i përket procedurës së trashëgimisë, ai tha se veprimet lidhur me procedurën trashëgimore e më pas përpilimin e kontratës, i ka ndërmarrë në kuadër të Ligjit për Noteri dhe se patjetër i ka kontrolluar ato dokumente të cilat kanë qenë të lëshuara nga organi kompetent, pra si dokument publik, vërtetimi i të cilave është bërë nga noteri që i ka përpiluar dhe noterizuar dhe në këtë rast si noter që ishte, ka qenë i mjaftueshëm të konstatojë pranueshmerinë e dokumenteve dhe përputhshmërinë e dokumenteve të bashkëngjitura në raport me autorizimin.

Autorizimi bartës, tha se ka pas të bëjë vetëm për shitblerje të paluajtshmrisë, ndërsa për procedurën trashëgimore tha se kanë qenë katër autorizime individuale e që gjenden në shkresat e lëndës.

Sa i përket aktvdekjes, tha se e ka pranuar si dokument publik, lëshuar nga Ofiqaria në Krushevc-Serbi, e pajisur me vule përkatëse të Gjykatës Themelore në Krushevc, në të cilën nuk ka shënuar afërsia gjinore e trashëgimlënësit me trashëgimtarët, por meqenëse ka qenë fjala për dokument publik, ka konsideruar se këta persona të shënuar në aktvdekje janë trashëgimtar ligjor të trashëgimlënësit V. D. dhe për të kjo ka mjaftuar që ata t'i konsiderojë si trashëgimtar legjitim, e më pas procedurën e shitblerjes së paluajtshmerisë e cila procedurë është zhvilluar pas përfundimit të procedurës trashëgimore dhe shpalljen e trashëgimtarëve ligjor, i është qasur përpilimit të kontratës së shitblerjes, duke ju referuar aktvendimit trashëgimor, ku si trashëgimtar të rendit të dytë ishte shpall D.M.. Ka sqaruar se në bazë të aktvdekjes së vërtetuar nga gjykata dhe katër autorizimeve të lëshuara dhe vulosura nga N.S. - notere, për të shpall trashëgimtarët, i kanë mjaftuar pra autorizimet individuale të katër trashëgimtarëve me të cilat e kanë autorizuar M.K., që në emër të tyre të inicion procedurën trashëgimore dhe të parashtrojnë deklarata trashëgimore, i cili vendim nuk ishte kontestuar asnjëherë nga ndonjë pjesëmarrës ose nga ndonjë person i tretë.

Më tej shtoj se, autoriteti kompetent që i lëshon aktvdekjet në Serbi, është ofiqari i gjendjes civile, e meqë ka pas të bëjë me një dokument të Serbisë, ka qenë e nevojshme të vërtetohet në gjykatë dhe të vihet vula apostile, ashtu siç ka ndodhur dhe se nuk kishte njohuri se ka ndalesë nga organet e Republikës së Kosovës, për përdorim të dokumenteve të lëshuara nga organet zyrtare apo noterët e Serbisë. Në praktikë tha se shpesh ka ndodhur që për qytetarët që kanë



jetuar në Kosovë dhe që kanë interesa pasurore në Kosovë, të pranohen autorizimet, deklaratat dhe shkresat tjera dhe anasjelltas, në Serbi janë akceptuar dokumentet e lëshuara nga noterët e Kosovës, për procedurat përkatëse që janë zhvilluar në Serbi.

Ka përsëritur, se ka vepruar në përputhshmëri me dispozita ligjore, dokumentet të cilat kanë qenë në dosje kanë qenë të harmonizuara ndërmjet veti, nuk ka pasur asgjë kontestuese sa i përket formës dhe rregullshmërisë së tyre juridike. Gjatë procedurës nuk ka pasur asnjë dyshim se ndonjë dokument është falsifikuar sepse kanë qenë të pajisura me të gjitha klauzolat, vulat, nënshkrimet dhe format tjera të mbrojtjes së dokumentit, prandaj palëve kontraktuese ju ka garantuar se lënda është kompletuar.

### Përmbajtja e fjalës përfundimtare

Prokurorja e Shtetit Valbona Disha Haxhosaj në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim me datë 02.07.2024, ka bërë ndryshimin e përshkrimit faktik të veprës penale, të plotësuar në pika të shkurta në seancën e datës 15.07.2024, ku mes tjerash tha mbi bazën e vërtetimit të gjendjes faktike në shqyrtim gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari B.S., nuk ka vepruar në pajtim me detyrat e tij zyrtare me nenin 3 par.1, pika 1.4.2 të Ligjit për Noterinë, rrethanë e vërtetuar në bazë të aktvdekjes së lëshuar në emër të V. (N.) D. dhe certifikatave të lindjes së trashëgimtarëve D. dhe , nga të cilat ndërlihur dhe me dëshminë e tyre ka rezultuar se të njëjtat nuk kanë qenë trashëgimtare legjitime të V. (N.) D., të cilin e kanë pasur axhë përkatësisht bashkëshort, sepse i njëjti kishte lënë tre fëmijë të rendit të parë, andaj dhe i akuzuari duke mos i vlerësuar trashëgimtarët e cekur në aktvdekje edhe përkundër se nuk ishin trashëgimtar legjitim, megjithatë ajo tha se ishin shënuar në rubrikën e parë që kishte të bëjë me trashëgimtar të rendit të parë dhe duke anashkaluar këtë konstatim në aktvdekje në kundërshtim me këtë shpall trashëgimtar të rendit të dytë M. D., pa i verifikuar fare dokumentet e vërtetuara pranë noteres N.S., ku më pas në bazë të aktvendimit të trashëgimisë përpilon dhe kontratë të shitblerjes bazuar në autorizimin bartës të vërtetuar tek noterja N.S., pa i verifikuar të njëjtat.

Në veçanti ka potencuar se gjykata nuk duhet fal besimin dëshmitarit Sh.H. të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 02.07.2024, për faktin se fillimisht ai nuk është ekspert i kësaj çështje, e po ashtu i njëjti në pyetjet e prokurorisë dhe gjykatës, vazhdimisht është shprehur duke thënë sipas mendimit tim, andaj konsideron se dëshmia e tij nuk është bazuar në Ligjin mbi Noterin, e as në punën praktike reale. Po ashtu i ka propozuar gjykatës që Aktvendimi mbi

Trashëgimin nr. 2711/20 Ref. 1052/2020 dhe të gjitha veprimet tjera të ndërmarra nga noteri B.S., të anulohen.

Në fund të fjalës përfundimtare ka propozuar që i njëjti të shpallet fajtor, të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në pagimin e shpenzime të procedurës penale.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit L.B., av. Sokol Mushkolaj, ka mbështet fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit derisa në fjalën përfundimtare të përpiluar në formë të shkruar tha se mbi bazën e provave të administruara i njëjti të shpallet fajtor, të dënohet sipas ligjit dhe në pajtim me nenin 322 të KPPRK-së, gjykata të obligoj të akuzuarin në pagesën e dëmit që në lartësi prej 92.000 €.

I dëmtuari L.B., e ka mbështetur fjalën përfundimtare të përfaqësuesit të tij.

Përfaqësuesi i autorizuar i palëve të dëmtuara M.D. , M.D., M.T. dhe M.D., av. Osman Cucoviq, ka mbështet fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit derisa në fjalën përfundimtare të përpiluar në formë të shkruar tha se me administrimin e provave u vërtetua pretendimi i aktakuzës dhe në pajtim me nenin 457, 459, 461 dhe 464 të KPPRK-së, i ka propozuar gjykatës që veprimet juridike të cilat janë rezultat i veprimeve inkriminuese të të akuzuarit t'i anuloj, pasi ka vlerësuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.S., av. Bujar Bërdynaj, në fjalën përfundimtare të përgatitur në formë të shkruar, tha se nga provat e administruara nuk u vërtetua teza e aktakuzës, kjo sepse dëshmitari Sh.H., elaboroj të gjitha dispozitat ligjore të Ligjit për Noterin;, kërkoj nga gjykata që të njëjtit t'ia fal besimin për shkak se në këtë çështje konsideron se është njeri me adekuat që ka interpretuar këto dispozita, kjo sepse aktakuza e ngritur është në shkelje të këtyre dispozitave ligjore të Ligjit për Noterinë. Andaj i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta liroj nga aktakuza, sepse nuk ka prova që e argumentojnë që i njëjti ka shkelur Ligjin për Noteri. Sa i përket pjesës tjetër, është thënë në fjalën përfundimtare me shkrim e cila do të mbetet pjesë përbërëse e shkresave të lëndës.

I akuzuari B.S., e ka përkrah në tërësi fjalën e mbrojtësit të tij, duke shtuar se me rastin e përpunimit të kësaj lënde vërtetë nuk ka pas asnjë interes, nuk ka pas asnjë motiv dhe asnjë qëllim që ta favorizoj apo ta dëmtoj ndonjëherë nga palët kontraktuese. Kontratën për shitjen e

paluajtshmerisë e ka përpiluar në bazë të dokumenteve që kanë arritur në zyrën e tij noteriale dhe në tërësi i është përmbajtur rregullave ligjore të përpunimit noterial të dokumentit. Prandaj është deklaruar plotësisht i pafajshëm.

*Vlerësimi i provave dhe ndërlidhja e tyre në raport me veprimet e të akuzuarit*

Gjykata pas administrimit të provave në seancën e shqyrtimit kryesor, e në kuptim të nenit 363 par.1, pika 1.3 KPPRK-së, duke i vlerësuar me ndërgjegje çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, e në bazë të vlerësimit të tillë ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nuk ishte kontestuese se i akuzuari B.S. me profesion ishte noter në Pejë dhe kishte cilësinë e personit zyrtar, tani i pensionuar.

Nuk ishte kontestues fakti se me datë 15.10.2020, kishte zhvilluar procedurë trashëgimie me dokumente të noterizuara në Serbi nga noterja N.S. nga Beogradi, për trashëgimtarët M.D. , M.D., M. D. dhe M.T. , sipas aktvdekjes së lëshuar në emër të trashëgimlënësit V. D. N..

Nuk ishte kontestuese se me Aktvendimin mbi Trashëgiminë me numër rendor 2711/2020 ref. 1052/20 të datës 15.10.2020, trashëgimtar i vetëm ishte shpall D.M..

Në vitin 2020 (regjistri i ndryshimeve 330/2020) ½ e ngastrave kadastrale si më lartë, nga V. N. D., kalojnë në pronësi të M.R.D. me ½ e ½ pronësisë në bazë të Aktvendimit mbi Trashëgiminë me numër rendor 2711/2020 ref. 1052/20 të datës 15.10.2020 (që është objekt akuze i përpiluar nga noteri B.S.).

Nuk ishte kontestuese se më pas ishte përpiluar kontrata e shitblerjes me numër rendor 3230/2020 ref.1265/2020 të datës 01.12.2020 nga këtu i akuzuari B.S..

Nuk ishte kontestuese se prona më pas ishte bartur në emër të L.B., F.H. dhe S.I. me nga 1/3 në bazë të kontratës së shitblerjes me numër rendor 3230/2020 ref.1265/2020 të datës 01.12.2020 përpiluar nga këtu i akuzuari B.S., e që është objekt akuze.

Nuk ishte kontestuese se i gjithë dokumentacioni që ka të bëjë me procedurë të trashëgimisë i noterizuar tek noterja N.S. , përfshirë dokumentacionin lidhur me kontratën e shitblerjes, poashtu të noterizuara tek noterja N.S. , pasi prona ishte shitur, kishte rezultuar i falsifikuar.

Kontestuese mbeti rrethana nëse i akuzuari nuk i kishte përmbush detyrat e tij zyrtare të parapara me nenin 3 par.1, pika 1.4.2 të Ligjit për Noterinë dhe nenin 12, 14 dhe 15 të Ligjit për Trashëgimin, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për shitësin M.K..

Kontestues mbeti rrethana se a kishte pas obligim i akuzuari të verifikonte këtë dokumentacion të noterizuar nga noterja në fjalë, para se të fillojë me procedurë të trashëgimisë, në veçanti aktvdekjen e lëshuar në emër të V. D. N., në të cilën ishin shënuar emrat e trashëgimtarëve në rubrikën e trashëgimtarëve të rendit të parë, derisa në vendim trashëgimie, trashëgimtar ishte shpall M. D., i rendit të dytë.

Gjykata duke vlerësuar konstatimet e dëshmitarëve L.B., M.K. dhe F.K., ka ardhur në përfundim se deponimeve të tyre duhet fal besimin për rrethanat jokontestuese, pas parasysh se të gjithë njëjloj thanë se dokumentacioni për kryerjen e trashëgimisë dhe shitblerjes së paluajtshmërisë ishte siguruar nga M.K., përmes personit me emrin D. M., i cili paraprakisht i kishte noterizuar tek noterja në Serbi, N.S. , në mesin e të cilave kishte qenë dhe aktvdekja e lëshuar nga Ofiqaria në Krushevc të Serbisë, me vule apostile të Gjykatës në Serbi.

Që të tre këta dëshmitarë e thanë njëjloj se pasi ishte kryer e gjithë procedura e trashëgimisë dhe shitblerjes së pronës dhe ishte bartë në regjistër kadastral në emër të blerësve, kishin kuptuar se të gjitha autorizimet e trashëgimtarëve dhe autorizimet për shitjen e pronës, përfshirë dhe autorizimin bartës në emër të M.K.t, letërnjoftimet e tyre si dhe aktvdekja, kishin rezultuar të falsifikuara, kjo pasi nga ILECU ishte verifikuar dhe për këtë ishin njoftuar organet kompetente në Kosovë, kjo pasi trashëgimtaret M.D. , M.D. dhe M.T. , me të ardhur në Kosovë, kanë kuptuar se prona e tyre ishte shitur pa dijenin e tyre, andaj dhe rastin e kanë paraqitur në polici, ku si i dyshuar ka qenë M.K. dhe D. M., andaj dhe u fali besimin.

Referuar pretendimeve të prokurorisë, ku pas ndryshimit të përshkrimit faktik të veprës penale për të cilën është akuzuar, se veprimet inkriminuese të të akuzuarit, konsistojnë në mos verifikim të dokumentacionit të sjellë nga M.K., në veçanti aktvdekjen, gjykata vlerësoj se të gjithë

dëshmitarët e dëgjuar, thanë se këtu i akuzuari, u kishte thënë se çdo gjë ishte në rregull, këtë nuk e mohoj as vet i akuzuari, rrethanë e vërtetuar dhe nga vet i akuzuari.

Se a është dashur u akuzuari të verifikojë origjinalitetin e dokumentacioni, këta dëshmitarë nuk dëshmuar sepse nuk kanë pyetur me tej, pasi veç noteri, këtu i akuzuari, u kishte thënë se janë në rregull dhe të kompletuara.

Sa i përket dëshmitareve/dëmtuarave M.D. , M.D., gjykata vërtetoi se të njëjtat me të ardhur në Kosovë diku në vitin 2020, për të vizituar varrezat, njëkohësisht kanë vizituar dhe pronën e tyre si trashëgimtare në 1/3 e paluajtshmërisë që gjendet në Vitomiricë, kanë kuptuar se e gjithë prona ishte shitur, përfshirë dhe ½ e saj që ishte në emër të xhaxhait të tyre.

Që të dyja këto dëshmitare, thanë se tani i ndjeri V. D.- ishte bashkëshorti i M.D. dhe baba i M.D. dhe M.T. , me të cilin kishin jetuar banesën e tij në Pejë në rr. “Ganimete Terbeshi” nr. 3, ndërsa tokën e ka pas në Vitomiricë në sipërfaqe prej 1 hektar e gjysmë dhe 1 hektar e gjysmë ka qenë e axhës. Pas vdekjes së babit në vitin 1996, në vitin 2005, kishin zhvilluar procedurë të trashëgimisë në Çaçak, pasi atje kanë qenë me banim, ashtu që si trashëgimtarë të rendit të parë janë shpall bashkëshortja e tij M., motra e dëshmitares, M.T. dhe M. D. me 1/3, derisa axha i tyre V. D. N., kishte ndërruar jetë në vitin 2012, por edhe pse kishte lënë pas trashëgimtar të rendit të parë, trashëgimia nuk ishte kryer, derisa për personin e shpallur si trashëgimtar të rendit të dytë, për tani të ndjerin V. D. N., nga noteri Bashkim, pra personin me emrin D.M., thanë se nuk e kanë në farefisni, por pasi kishin kuptuar se pasuria e tyre ishte shitur, kanë verifikuar dhe kanë vërtetuar se ekziston një M. D., i cili ishte i paralizuar, por asnjëherë nuk e kanë parë e as takuar.

Poashtu të njëjtat thanë se aktvdekja e lëshuar në Krushevc me datë 07.09.2020 për V. D. N., ku si trashëgimtar ka rezultuar të jenë D.M., D.M., T.M.dhe D.M., që ka të bëjë me pronën që e ka lënë në Vitomiricë, prej 1 hektar 76 ari është e falsifikuar, këtë e kanë verifikuar pas inicimit të rastit në polici, siç kanë vërtetuar se janë të falsifikuara dhe të gjitha autorizimet në emër të tyre dhe deklaratat trashëgimore, përfshirë dhe letërnjoftimet e tyre, pasi noteren N.S. , asnjëherë nuk e kanë takuar e as nuk e kanë njohur.

Poashtu potencuan se aktvdekja, ka kohë që nuk lëshohet në Serbi edhe pse këtë e kishin kuptuar pasi kanë shkuar në ofiqari dhe nga një zyrtar aty e kishin kuptuar këtë rrethanë.

Andaj, kjo gjykatë deponimet e tyre i mori të sakta dhe në përputhje të plotë me prova materiale, mirëpo sa i përket veprimeve inkriminuese të të akuzuarit këto dëshmitare nuk vërtetuan ndonjë fakt përpos se dyshimet i kishin se M.K. ishte mashtruesi me personin e paidentifikuar, i ashtuquajtur M. D., derisa B.S.n e kishin takuar pasi kanë kuptuar kush i ka ndërmarrë veprimet për trashëgimi dhe shitje, e sipas tyre, ai aty e kishte kuptuar se paska rënë në lajthim nga persona tjerë.

Nga dëshmia e dëshmitarit Sh.H., kjo gjykatë vërtetoi faktin se noteri, sa i përket dokumentacionit që është i noterizuar në ndonjë shtet tjetër përfshirë dhe shtetin e Serbisë, qoftë autorizim apo dokument tjetër, vetëm nëse ka formën e duhur, pranohet.

Vërtetoi faktin se për t'u përpiluar një kontratë për shitblerje mbi bazën e autorizimit bartës, nuk është e nevojshme t'i ketë edhe autorizimet burimore, është e mirëseardhur që të jenë në shkresat e lëndës, mirëpo ato mbasin tek noteri që e ka bërë autorizimin bartës.

Vërtetoi faktin se noteri ka për obligim në çdo rast të informojë klientët se autorizimet e prezantuara në shikim janë përpiluar dhe vërtetuar në mënyrë të rregullt ligjore dhe si të tilla i pranon çdo noter, pra si të ligjshme dhe të vërteta dhe në secilin akt noterial, ju tërhiqet vërejtja palëve për këtë çështje.

Vërtetoi faktin se si dokumentacion për shitjen e paluajtshmerisë, fillimisht kërkohet certifikata e pronësisë, për të verifikuar kush është pronar i asaj prone, pronari identifikohet me dokument identifikues letërnjoftim apo pasaportë nëse është prezent, nëse përfaqësohet nga avokati apo ndonjë person tjetër kërkohet autorizimi i personit që përfaqëson, dokumenti identifikues merret vetëm në shikim, në këtë rast autorizimi duhet të jetë i vërtetuar nga organi kompetentë si noteri, gjykata apo ndonjë shërbim tjetër varësisht nga shteti që aplikon. Noteri mund të verifikoj nënshkrimin e autorizim dhënësit vetëm në shikim, ku bëhet verifikimi i nënshkrimit në letërnjoftim apo pasaportë.

Vërtetoi faktin se për procedurë të trashëgimisë, si dëshmi duhet të jetë aktvdekja si dokument kryesor i cili normal duhet të jetë i lëshuar nga ofiqari, si bazë për iniciimin e procedurës trashëgimore për të ndjerin. Dokumentet që pranohen, duhet të kenë përmbajtje të saktë për trashëgimtarët e shënuar në aktvdekje dhe pasurinë që e ka bartë mbi vete.

Vërtetoj faktin se gjatë shqyrtimit të trashëgimisë bëhen disa deklaratë shtesë bashkë, pra se a janë gjithë trashëgimtarët e shënuar apo ka edhe tjetër.

Vërtetoj faktin se këto deklaratë i japin të pranishmit do të thotë trashëgimtarët, e nëse janë me autorizim, do të shënohet në atë autorizim i cili mund të jetë bashkë me deklaratë që duhet të ceket se janë trashëgimtar legjitim të trashëgimlënësit.

Vërtetoj faktin se pranimi i dokumentacionit bëhet në bazë të reciprociteti faktik që nënkupton pranimin e dokumenteve të Kosovës, pra noteriale nga shtetit tjetër që më pas edhe nga noterët në Kosovë, pranohet dokumenti i shtetit tjetër, e që janë me mijëra autorizime që janë përcjell në shtetin e Serbisë dhe të gjitha janë pranuar, qoftë për qytetar qoftë për pensionist.

Vërtetoj faktin se aktvdekja, lëshohet nga ofiqaria, por sa i përket Serbisë nuk ishte në dijeni, pasi nuk kanë ndonjë njoftim zyrtar, por nëse aktvdekja lëshohet nga ofiqaria dhe merr vule apostile në gjykatë, ai mund të jetë i pranueshëm.

Vërtetoj faktin se në aktvdekje nuk është obligative të shënohet emri dhe mbiemri i trashëgimtarit dhe lidhja e gjakut, një gjë e tillë nuk shënohet as në aktvdekje që lëshohen në Kosovë edhe pse ishte dashur të shënohen, e në rastet kur nuk shënohet verifikohet në bazë të dokumenteve tjera, por në vendim të trashëgimisë, duhet të potencohet nëse është trashëgimtar i rendit të parë apo të dytë, kjo mjafton, për shkak se e gjithë procedura trashëgimore bazohet në autorizime dhe deklaratë trashëgimore që i sjell i autorizuari.

Vërtetoj faktin se dokumentacioni i dhënë në shikim lidhur me zhvillimin e procedurës së trashëgimisë, ishte në rregull dhe i kompletuar.

Vërtetoj faktin se në deklaratë trashëgimore nuk është e thënë që të shënohet se në dobi të kujt heqin dorë, është e mjaftueshme të shënohet se nuk e pranon pjesën trashëgimore.

Vërtetoj faktin se Ligji për Trashëgimin parasheh tri deklaratë trashëgimore, e pranoj pjesën trashëgimore, nuk e pranoj, e pranoj dhe ja cedoj personit të caktuar.

Vërtetoj faktin se autorizimi bartës numër 7034/2020 që ka të bëjë me shitjen e patundshmërive, mbi bazën e të cilit është përpiluar kontrata, është i mjaftueshëm, për noterin të përpiloj kontratë.

Referuar aktvdekjes për të ndjerin V. D., ku në kolonën afërsia nën “a” tek fëmijët martesor, jashtë martesor dhe të adoptuar janë konstatuar emrat e trashëgimorëve D.M., D.M., M.T. dhe D.M., vërtetoj faktin se sipas shënimit në aktvdekje, ata janë trashëgimtar të rendit të parë.

Vërtetoj faktin se edhe përkundër se nuk është shënuar lidhja e gjakut në aktvdekje, vendimi trashëgimisë merret në bazë të deklaratave të trashëgimtarëve dhënë tek noteri apo përmes deklaratave trashëgimore me autorizim vendimi duhet të ketë emrat e trashëgimtarit në përputhje me emrat e cekur në aktvdekje dhe mjafton që në vendim të ceket radha e trashëgimisë siç e ka cekur këtu i akuzuari, sepse nëse kanë qenë katër trashëgimtar, tre heqin dorë nga pjesa trashëgimore dhe mbetet vetëm një, vlerëson se është në rregull, nëse në deklarata trashëgimore kanë deklaruar se heqin dorë nga pjesa trashëgimore.

Se këto fakte të vërtetuara nga dëshmitari Sh.H. u morën të besueshme, kjo gjykatë erdhi në përfundim se i njëjti ju referua dispozitave ligjore të Ligjit për Noterinë, e i cili më pas konfirmoj se i gjithë dokumentacioni i dhënë në shiqim që kishte të bëjë me procedurë të trashëgimisë dhe të kontratës së shitblerjes, ishte i kompletuar në përputhje me ligjin, andaj dhe nuk pati arsye të mos i fal besimin, dëshmi e cila gjeti përputhje të plotë dhe me mbrojtjen e të akuzuarit, i cili njëjtoj sqaroj se veprimet e ndërmarra i kishte bazuar në ligj, pasi kishte vlerësuar se i gjithë dokumentacioni ishte në pajtim me formën dhe përmbajtjen e përcaktuar me ligj.

Në vlerësim të mbrojtjes së të akuzuarit, i cili ka mohuar kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar me arsyetim se për zhvillimin e procedurës trashëgimore, e më pas edhe përpilimin e kontratës për shitblerjen e patundshmërisë, nën arsyetim se ka pas gjithë dokumentacionin që kërkohet, pra ka pas certifikatën e vdekjes për trashëgimlënësin V. D., aktin e vdekjes të vërtetuar nga Ofiqaria në Kryshevc dhe të vërtetuar nga Gjykata Themelore në Kryshevc, me emrat e trashëgimtarëve ligjor të trashëgimlënësit dhe autorizimet e kompletuara me të gjitha shënimet personale të nënshkruara nga palët, ndërsa letërnjoftimet e tyre kanë qenë të vërtetuara me klauzolën mbi vërtetimin e identitetit nga noterja N.S. , të gjitha e kanë pas formën e duhur ligjore të punuara nga një noter profesional që nuk ka lënë hapësirë për asnjë dyshim se ato mund të jenë të falsifikuara, kjo gjykatë përfundoj se mbrojtja e tij ishte në përputhje me deklarin të dëshmitarit Sh.H., i cili pas shikimit të dy dosjeve, konfirmoj se të gjitha kanë vule, përmbajtje



dhe formë të rregullt ligjore, këtë e vërtetuan dhe dëshmitarët L. Dhe M., të cilët thanë se noteri u kishte thënë se çdo gjë ishte në rregull, përfshirë dhe aktvdekjen, të cilën e ka pranuar si dokument publik, lëshuar nga Ofiqaria në Krushevc- Serbi, e pajisur me vule përkatëse të Gjykatës Themelore në Krushevc edhe përkundër se nuk ishte shënuar afërsia gjinore e trashëgimlënësit me trashëgimtarët, por meqenëse ishte fjala për dokument publik, ka konsideruar se personat e shënuar në aktvdekje janë trashëgimtar ligjor të trashëgimlënësit V. D. dhe për të kjo ka mjaftuar që ata t'i konsiderojë si trashëgimtar legjitim, duke shpallur trashëgimtar të vetëm D. M. si të rendit të dytë, bazuar në autorizimet individuale të katër trashëgimtarëve me të cilat e kanë autorizuar M.K., që në emër të tyre të inicion procedurën trashëgimore dhe deklaratave të tyre trashëgimore bashkëngjitur autorizimeve, i cili vendim nuk ishte kontestuar asnjëherë nga ndonjë pjesëmarrës ose nga ndonjë person i tretë, andaj gjykata mbrojtjes së tij i fali besimin, sepse nuk u provua me asnjë provë pretendimi i akuzës, andaj dhe i fali besimin.

### Vlerësimi juridik

Vepra penale *Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni neni 414 par. 2 të KPRK-së*, për të cilën është akuzuar B.S., përbëhet nga elementet objektive e që janë veprimi dhe pasoja (Actus Reus) ashtu si dhe nga qëllimi kriminal (Mens rea) lidhur me secilin element të veprës penale. Për të ekzistuar një vepër penale, këto elemente duhet të përmbushen në mënyrë kumulative. Vepra penale në fjalë, si e tillë, mund të kryhet me veprim dhe vetëm me dashje direkte të kryesit. Kur jemi tek dashja, e njëjta duhet të paraqitet si në veprim e poashtu edhe në pasojë, sidomos tek vepra penale që është objekt shqyrtimi, pasi që forma të tjera të fajit, tek kjo vepër nuk mund të vijnë në shprehje.

Fillimisht gjykata sqaron se si element qenësor për të ekzistuar vepra penale e Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 të KPRK-së, është tejkalimi i autorizimeve nga ana e personit zyrtar apo mos përmbushja e detyrave zyrtare.

Pra nga ky përkufizim ligjor sipas nenit 414 paragrafi 1 të KPRK, rezulton se kjo vepër penale përbëhet prej këtyre elementeve:

*“Kryes i kësaj vepre penale duhet të jetë personi zyrtar.*

*Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar,*

*Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë : në tejkalimin e kompetencave ose mos përmbushjen e detyrave zyrtare dhe*

*Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me qëllimin e kryesit që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e personit tjetër.”*

*Ndërsa paragrafi 2 i nenit 414 të KPPRK-së, ka përcaktuar se: “Për qëllime të këtij neni, shpërdorimi i detyrës zyrtare përfshinë, por nuk kufizohet në”: nën paragrafi 2.2. ka përcaktuar moskryerja me dashje e ndonjë detyre të domosdoshme të përcaktuar me ligj; ndërsa nën paragrafi 2.3. ka përcaktuar: pranimi i dhuratës, tarifës apo përparësisë së çfarëdo lloji si rezultat i kryerjes së detyrës zyrtare, përveç nëse pranimi i dhuratës, tarifës apo përparësisë lejohet me ligj”*

Sipas nenit 3 të Ligjit Nr. 06/L-010 për Noterinë, janë përcaktuar Autorizimet e noterit:

*1. Noteri është i autorizuar të kryej këto punë: 1.1. përpilon, vërteton dhe lëshon dokumente noteriale; 1.2. vërteton dokumentet noteriale të cilat janë hartuar nga pala apo një person i tretë; 1.3. pranon për ruajtje dokumente, para të gatshme, urdhërpagesa, çeqe, obligacione publike dhe letra me vlerë dhe sende tjera; 1.4. ndërmerr të gjitha veprimet në procedurë jokontestimore/trashëgimore, ku përfshihen por nuk kufizohet në: 1.4.1. përpilimin e testamentit noterial; 1.4.2. shqyrtimin e pasurisë trashëgimore dhe vendos me aktvendim për trashëgiminë në rastet jokontestimore; 1.4.3. vlerësimet dhe shitjet publike të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshëmërive në procedurën jokontestimore, veçmas në rastet e shitjeve vullnetare; 1.4.4. ruajtjen e dokumenteve të trashëgimisë, të parave, letrave me vlerë apo sendeve të çmueshme. 1.5. kryen edhe punët e tjera të besuara me ligj të veçantë, par 2. I nenit në fjalë përcakton se dokumentet noteriale janë: 2.1. aktvendimi për trashëgiminë jokontestimore; 2.2. dokumentet për punë juridike dhe për deklaratat të cilat i kanë përpiluar noterët(akti noterial); 2.3. dokumentet e përpiluara nga pala apo një person i tretë dhe të vërtetuara/solemnizuara nga noteri (vërtetim noterial); 2.4. procesverbalet për veprimet juridike të cilat i kanë kryer ose në të cilat kanë qenë të pranishëm noterët (procesverbalet noteriale); dhe 2.5. vërtetimi i fakteve të cilat në kuadër të autorizimeve i vërteton noteri dhe vërtetimi i kopjeve, nënshkrimeve dhe*

*shënimeve të tjera (vërtetimi noterial). Derisa par 3. përcakton se dokumentet noteriale të lëshuara sipas këtij ligji kanë fuqinë e dokumenteve publike, nëse me rastin e hartimit dhe lëshimit të tyre janë plotësuar formalitetet themelore të parapara me ligj. Dokumenti noterial ka fuqinë provuese dhe është dokument përmbarimor në rastet e parapara me ligj. parr 4 i nenit në fjalë parasheh që: Vërtetësia dhe zbatueshmëria e dokumenteve të noterizuara bazohet në nënshkrimin, formën dhe përmbajtjen e dokumentit. Dokumentet e noterizuara gëzojnë supozimin e dyfishtë të ligjshmërisë. Ato mund të kontestohen vetëm përmes procedurave gjyqësore. Dhe par 5. Përcakton se Dokumentet noteriale të lëshuara nga shteti tjetër, në kushtet e reciprocitetit, kanë efektin e njëjtë juridik sikurse dokumentet noteriale të lëshuara sipas këtij ligji. Dokumentet e huaja noteriale mund të jenë dokumente përmbarimore, nëse kanë të bëjnë me të drejtat të cilat nuk janë në kundërshtim me rendin juridik të Republikës së Kosovës dhe nëse përmbajnë të gjitha elementet të cilat sipas ligjit janë të domosdoshme për përmbarim. 6. Për veprimet nga paragrafi 1. nën-paragrafi 1.4. të këtij neni, përshtatshëm vlejnë dispozitat e ligjit përkatës për trashëgiminë dhe procedurën jokontestimore.*

Siç është theksuar edhe më lartë i akuzuari ka qenë zyrtar publik dhe në suaza të veprimeve të autorizuar me neni 3 të ligjit në fjalë, ka ndërmarrë veprimet e përshkruara më lartë.

Prokuroria pretendon se i akuzuari nuk i ka përmbush detyrat e tij zyrtare të parapara me nenin 3 par.1 pika 1.4.2, (*shqyrtimin e pasurisë trashëgimore dhe vendos me aktvendim për trashëgiminë në rastet jokontestimore*), ndërlidhur me nenin 12, 14 dhe 15 të Ligjit për Trashëgimin e Kosovës (2004/26), mirëpo bazuar në provat e administruara, gjykata vërtetoi faktin se i akuzuari ka ndërmarrë të gjitha veprimet në procedurë jokontestimore/trashëgimore, pra ka bërë shqyrtimin e pasurisë trashëgimore dhe ka vendos me aktvendim për trashëgiminë, është vërtetimi i fakteve në kuadër të autorizimeve, ka përcaktuar se dokumentet noteriale të lëshuara sipas këtij ligji kanë fuqinë e dokumenteve publike, prandaj me rastin e hartimit dhe lëshimit të tyre ka vlerësuar se janë plotësuar formalitetet themelore të parapara me ligj, rrethana të vërtetuara nga vet i akuzuari, mbrojtja e të cilit u harmonizua me të gjitha provat materiale të dosjes së trashëgimisë dhe kontratës së shitblerjes, të cilat i konfirmoj si të rregullta edhe dëshmitari Sh.H., si kryetar i odës së noterëve, njëkohësisht dhe noter aktual.

Gjegjësisht i akuzuari dokumentet e noterizuara, i mori si të rregullta, bazuar në nënshkrimin, formën dhe përmbajtjen e tyre, siç përcaktohet në paragrafët e nenit 3 të cituar më lartë, parregullsia e të cilave sipas këtyre dispozitave, mund të kontestohen vetëm përmes procedurave

gjyqësore, sepse dokumentet noteriale të lëshuara nga shteti tjetër, në kushtet e reciprocitetit kanë efektin e njëjtë juridik sikurse dokumentet noteriale të lëshuara sipas këtij ligji rrethanë e vërtetuar dhe nga raporti njoftues i Policisë së Kosovës i datës 19.10.2024, *ku mes tjerash është thënë se nuk ka dispozitë ligjore konkrete që e ndalon përdorimin apo jo të autorizimeve të lëshuara nga ana e noterëve të cilët veprojnë në R. Serbisë, e as që kanë ndonjë vendim apo akt ligjor të organeve kompetente qeveritare lidhur me përdorimin apo jo të këtyre dokumenteve,* dhe se çështja i është lënë në vlerësim të secilit noter, e që në rastin konkret këtu i akuzuari tha se nuk ka pas mundësi reale të kuptojë se të njëjtat kanë qenë të falsifikuar dhe si të tilla i ka pranuar në bazë të reciprocitetit.

Prokuroria poashtu pretendon se në aktvdekje, emrat e trashëgimtarëve, ishin shënuar në kolonë të parë, që ka të bëjë me trashëgimtarë të rendit të parë, ku dhe nuk ishte potencuar afërsia e gjakut me trashëgimtarët, derisa në vendim të trashëgimisë M. D., e kishte shpall trashëgimtar të rendit të dytë, pretendim i cili nga dëshmia e dëshmitarit Sh.H. dhe nga mbrojtja e të akuzuarit u sqarua, se në këtë rast, meqenëse trashëgimtar është shpall personi i cili ishte në aktvdekje i përfshirë si trashëgimtarë edhe përkundër se nuk ishte shënuar afërsia e gjakut me trashëgimtarët, procedura thanë se është e karakterit deklarativ, sepse nëse në deklarata trashëgimore është cek afërsia me trashëgimtarët, në aktvendim të trashëgimisë është e mjaftueshme të shënohet rendi i trashëgimisë, siç dhe ka ndodh në rastin konkret, vendim i cili ishte shpall në gazeta zyrtare dhe nuk ishte kontestuar nga askush.

Sa i përket pretendimit të prokurorisë se i akuzuari nuk përmbushi detyrat e tij në shkelje të nenit 12, 13 dhe 15 të Ligjit të Trashëgimisë, dispozita ligjore të cilat shprehimisht përcaktojnë se:

*“Pasardhësit dhe bashkëshorti i trashëgimtarit*

#### Neni 12

*Trashëgimtarët e trashëgojnë para të gjithëve fëmijët e tij dhe bashkëshorti i tij.*

*Personat nga paragrafi (1) i këtij Neni trashëgojnë në pjesë të barabarta.*

#### **RADHA E DYTË E TRASHËGIMISË**

*Prindërit dhe bashkëshorti i trashëgimlënësit*

*Neni 14*

*Pasurinë e trashëgimlënësit që nuk ka lënë pasardhës e trashëgojnë prindërit e tij dhe bashkëshorti i tij.*

*Prindërit e trashëgimlënësit trashëgojnë gjysmën e pasurisë në pjesë të barabarta, kurse gjysmën tjetër të pasurisë e trashëgon bashkëshorti i trashëgimlënësit.*

*Në qoftë se trashëgimlënësi nuk ka lënë bashkëshort, prindërit e trashëgimlënësit e trashëgojnë tërë pasurinë në pjesë të barabarta.*

*Në qoftë se të dy prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur para tij, bashkëshorti trashëgon tërë pasurinë.*

*Vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit dhe pasardhësit e tyre*

*Neni 15*

*Në qoftë se njëri nga prindërit e trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'i takonte sikur të kishte jetuar pas trashëgimlënësit e trashëgojnë fëmijët e tij (vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit), nipat e stërnipat e tij dhe pasardhësit e largët të tij, sipas dispozitave të këtij Ligji që vlejné për rastin kur trashëgimlënësin e trashëgojnë fëmijët dhe pasardhësit e tjerë të tij.*

*Në qoftë se të dy prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur para trashëgimlënësit, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'i takonte secilit prej tyre sikur të kishin jetuar pas trashëgimlënësit e trashëgojnë pasardhësit përkatës, siç është përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.*

*Në të gjitha rastet vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit vetëm nga ana e atit trashëgojnë në pjesë të barabarta pjesën e pasurisë trashëgimore të atit, vëllezërit dhe motrat vetëm nga ana e nënës trashëgojnë në pjesë të barabarta vetëm pjesën e nënës, kurse vëllezërit dhe motrat të së*

*njëjtës nënë dhe të të njëjtit at trashëgojnë në pjesë të barabarta me vëllezërit dhe motrat nga ana e të atit pjesën e të atit, kurse me vëllezërit dhe motrat nga ana e nënës pjesën e nënës.”*

Referuar këtyre dispozitave edhe përkundër se prokuroria nuk dha arsytim se si u shkelën këto dispozita ligjore, kjo gjykatë referuar provave materiale, në veçanti dosjes së procedurës së trashëgimisë dhe deklarimit të dëshmitarit Sh.H. si dhe mbrojtjes së të akuzuarit, erdhi në përfundim se edhe këto dispozita janë respektuar, kur shpalli trashëgimtarë të rendit të dytë M. D., vendim i cili ishte bazuar në deklaratat e trashëgimtarëve, siç ka sqaruar dhe dëshmitari Haskaj, i cili tha se as tek ne në Kosovë nuk shënohet afërsia në aktvdekje, por trashëgimtarë shpallen sipas deklarimit të trashëgimtarëve, procedurë e cila ka karakter deklarativ, andaj dhe verifikimi se a ishin vërtetë trashëgimtarë legjitim, apo të rendit të parë a të dytë, këtu i akuzuari nuk kishte obligim ta bënte, jashtë dokumenteve të cilat i ishin dorëzuar nga palët, procedura trashëgimore ishte udhëhequr mbi bazën e atyre dokumenteve të noterizuara, të cilat i ka vlerësuar të rregullta e në pajtim me nenin 3 të Ligjit për Noterinë.

Sa i përket pretendimit të prokurorisë se i akuzuari nuk përmbushi detyrat e tij zyrtare, në shkelje të dispozitave ligjore të cekura më lartë me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për shitësin M.K., për gjykatën ky pretendim mbeti i supozuar, sepse me asnjë prove të vetme nuk u vërtetua dashja apo dijenia e të akuzuarit se veprimet e tij i ka ndërmarrë me qëllim të përfitimit pasuror për M.K.n, e aq ma tepër kur në përshkrim faktik të ndryshuar në fjalë përfundimtare, si në dispozitiv të këtij aktgjykim, nuk u tha se cili ishte përfitimi i personit në fjalë.

Gjithashtu gjykata ka vlerësuar dëshminë e dëshmitarit L.B., M.K., F.K., M.D. , M. D., në raport me vërtetim të veprimeve inkriminuese të të akuzuarit, dhe edhe në përfundim se të gjithë këta dëshmitarë, përpos faktit se më vonë e kishin kuptuar se këto dokumente ishin të falsifikuara, nuk mundën të vërtetojnë pretendimet e aktakuzës, përkatësisht nuk mundën të vërtetojnë dashjen e të akuzuarit se të gjitha këto veprime i ndërmori me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për M.K.n, nuk mundën të vërtetojnë se ai ishte në dijeni se dokumentet ishin të falsifikuara dhe të parregullta, këta dëshmitar vërtetuan faktin se i akuzuari në cilësi të noterit, pasi kishte shiquar dokumentet në fjalë, kishte konstatuar se çdo gjë ishte në rregull, andaj dhe ka ndërmarrë veprime të procedurës trashëgimore dhe më pas procedure të shitjes së pronës, mbi bazën e autorizimeve të noterizuara, përkatësisht mbi bazën e autorizimit bartës në emër të M.K.t si shitës i pasurisë që ishte objekt i kontratës, pra se kishte vepruar drejtë këtë e vërtetoj dhe

dëshmitari Sh.H., i cili tha se dokumentacioni i procedurës trashëgimore dhe ai i shitblerjes, ishte në rregull dhe në përputhje me nenit 3 të Ligjit për Noterinë.

Gjithashtu, provat material, përkatësisht dokumentet e dosjes së procedurës së trashëgimisë dhe të kontratës së shitblerjes, të cilat u shikuan në origjinal nga gjykata, për të vërtetuar vërtetësinë e tyre, pasi si provë janë administruar në kopje në shqyrtim gjyqësor, nuk provuan fajësinë e të akuzuari, andaj dhe në mungesë të ndonjë prove tjetër, pra nuk ka pasur ndonjë provë tjetër të cilën gjykata e ka administruar nga e cila do të vërtetohej përgjegjësia e të akuzuarit, nuk ka pasur ndonjë provë e cila e ndërlihd të akuzuarin në raport me veprimet për të cilat ishte ngarkuar me aktakuzë dhe në bazë të kësaj ka ardhur në përfundim se nga provat e administruara dhe dëgjimi i dëshmitareve, i akuzuari nuk ka kryer veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarve në kontest të rregullt juridiko-civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, u morr konform nenit 462 par.3 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, është marrë në bazë të nenit 453 par.1 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 360 dhe 363 par.1.3 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**PKR.nr.82/23**

**Bashkëpunëtore profesionale**  
Elzana Kastrati

**Kryetarja e trupit gjyqës**  
Nushe Kuka Mekaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmjet kësaj Gjykate.